



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

1129/20

Datum: 25.01.2021

PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.1129/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Blerim Dina – Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.T.P “Biti Com”-Podujevë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “Lulishtja Buçaj” - Graçanicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim dhe mbletim të drunjve dekorativ në sheshin e qytetit” me nr. të prokurimit 615-20-7524-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Podujevë”, më datën: 15.01.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.T.P “Biti Com”-Podujevë, kundër njoftimit për dhënie të kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim dhe mbletim të drunjve dekorativ në sheshin e qytetit ” me nr. të prokurimit: 615-20-7524-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Podujevë.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim dhe mbletim të drunjve dekorativ në sheshin e qytetit ” me nr. të prokurimit: 615-20-7524-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Podujevë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.T.P “Biti Com”-Podujevë, aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues N.T.P “Biti Com”-Podujevë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 22.12.2020 me nr. 1129/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim dhe mbletim të drunjve dekorativ në sheshin e qytetit ” me nr. të prokurimit: 615-20-7524-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Podujevë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 3, 6, 7, 16, 4 pika 4.4.4, si dhe nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 25.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 06.01.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

OE ankues pretendon se AK ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 6,7,8,59, dhe 61 me rastin e vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit pasi që në vlerësim nuk ka marrë për bazë dispozitat e theksuar sepse për kontratë AK ka rekomanduar OE me çmim shumë më të ulët se sa mesatarja e ofertuesve të përgjegjshëm dhe shumëfish çmim më të ulët se sa vlera e parashikuar e kontratës. Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimet ankimore janë të bazuara për faktin se:

Autoriteti kontraktues me rastin e vlerësimit të nevojave për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë një buxhet në vlerë prej 40,5000.00 Euro ndërsa oferta e rekomanduar për kontratë është 12,300.00 Euro që do të thotë se për kontratë është rekomanduar OE i cili ofron çmim shumëfish më të ulët dhe kjo mund ta ve në pikëpyetje kualitetin e furnizimeve apo shërbimeve.

Fakti tjetër është se AK nuk ka marrë për bazë dispozitat e nenit 61 të LPP-së lidhur me tenderin abnormalisht të ulët pasi OE i rekomanduar jo vetëm që ofron çmim shumë më të ulët se sa vlera e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit, por ofron çmim edhe shumë më të ulët se sa mesatarja e çmimeve të tenderëve të përgjegjshëm. Eksperti konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e nenit 61 të LPP-së që oferta e OE “Lulishtja Buçaj” të trajtohet në kuptim të nenit të theksuar për arsye se konsiderohet

është ofertë që kalon pragun lejuar prej 30% se sa mesatarja e çmimeve të ofruara nga OE të cilët janë vlerësuar të përgjegjshëm, dhe është trefish më e ulët se sa vlera e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit. Parimi i efikasitetit dhe i efektivitetit nuk lidhet vetëm me çmimin e ultë por ka të bëjë me kualitetin e furnizimit dhe kualitetin e shërbimeve, dhe çmim i kontraktuar në raport me vlerën e parashikuar tregon qartë se ky parim nuk mund të përmbushet apo në të kundërtën nëse AK mendon se përmbushet atëherë cila është arsyeja që vet AK ka parashikuar një vlerë të buxhetit kaq të lartë për këtë aktivitet të prokurimit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Eksperti Shqyrtues konsideron se pretendimet ankimore janë të bazuar dhe i rekomandon AK-së që vlershmin ta bëjë në përputhe me nenin 59 dhe 61 të LPP-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 06.01.2021 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues me datë 08.01.2021, me anë të parashtrësës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik N.T.P "Biti Com"-Podujevë me datë 07.01.2021, me anë të parashtrësës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 15.01.2021, nëpërmjet platformës elektronike ZOOM, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurë.

OE ankues pretendon se AK me rastin e vlerësimit ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 6, 7, 8, 59 dhe 61 të LPP-së sepse ka rekomanduar për kontratë OE me çmim shumë më të ulët se sa mesatarja e ofertuesve të përgjegjshëm dhe shumëfish çmim më të ulët se sa vlera e parashikuar e kontratës. Për këtë pretendim ankimor, Paneli Shqyrtues sqaron se qëllimi i rregullave për tenderët jo normalisht të ulët është që të mos bëhet përjashtimi automatik në rastet kur për autoritetin kontraktues duket një tender jo normalisht i ulët. Mirëpo, përderisa autoriteti kontraktues konsideron se operatori ekonomik mund të përmbush kontratën me çmimet e ofruara dhe ka qëllim që fondet publike të përdoren në mënyrë më ekonomike, rezulton se nuk ka ndonjë kufizim apo pengesë për AK-në që të shpërblejë me kontratë. Megjithatë, Paneli Shqyrtues sqaron se

fillimisht është përgjegjësi e AK-së që të vlerësoj nëse OE mund ta përmbush kontratën me këto çmime, si dhe është obligim dhe përgjegjësi e AK-së që të kërkoj nga OE i rekomanduar që të rrit sigurimin e ekzekutimit në rast se dështon të përmbush kontratën.

Nëse i shikojmë çmimet e ofruara nga OE –të pjesëmarrës do te kemi si ne vijim:

Paramasa me paralogari Projekt "Mbjellja e drunjëve në sheshin e qytetit"

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi i pozicionit
1	Furnizimi dhe mbjellja: Rrap (Platanus orientalis) Lartësia e drurit prej tokës deri në përfundim duhet të jetë 3.30-3.50 m (diametri i trunqut Ø100 mm), e gjithë pjesa duhet të jetë e mbushur me gjethe. Fidanë duhet të jetë i kultivuar në vazo me dhe të mirë humusor dhe të ketë sistem rrënjorë mirë të zhvilluar. Fidanet duhet të jenë të zhvilluara në vazo me madhësi prej 55-65 litra. Furnizuesi për fidanet duhet të dëshmojë me certifikatë fitosanitare dhe të ketë dëshmi për prejardhjen e tyre nga vendet e BE – së.	copë	100	200	20000
2	Furnizimi dhe mbjellja: Acer platanoides Crimson King Lartësia e drurit prej tokës deri në përfundim duhet të jetë 3.30-3.50 m (diametri i trunqut Ø100 mm), e gjithë pjesa duhet të jetë e mbushur me gjethe. Fidanë duhet të jetë i kultivuar në vazo me dhe të mirë humusor dhe të ketë sistem rrënjorë mirë të zhvilluar. Fidanet duhet të jenë të zhvilluara në vazo me madhësi prej 55-65 litra. Furnizuesi për fidanet duhet të dëshmojë me certifikatë fitosanitare dhe të ketë dëshmi për prejardhjen e tyre nga vendet e BE – së.	copë	50	190	9500
				Çmimi pa TVSH	29500
				TVSH	3310
				Çmimi me TVSH	34810

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi i pozicionit
1	Furnizimi dhe mbjellja: Rrap (Platanus orientalis) Lartësia e drurit prej tokës deri në përfundim duhet të jetë 3.30-3.50 m (diametri i trunqut Ø100 mm), e gjithë pjesa duhet të jetë e mbushur me gjethe. Fidanë duhet të jetë i kultivuar në vazo me dhe të mirë humusor dhe të ketë sistem rrënjorë mirë të zhvilluar. Fidanet duhet të jenë të zhvilluara në vazo me madhësi prej 55-65 litra. Furnizuesi për fidanet duhet të dëshmojë me certifikatë fitosanitare dhe të ketë dëshmi për prejardhjen e tyre nga vendet e BE – së.	copë	100	145.00	14,500.00
2	Furnizimi dhe mbjellja: Acer platanoides Crimson King Lartësia e drurit prej tokës deri në përfundim duhet të jetë 3.30-3.50 m (diametri i trunqut Ø100 mm), e gjithë pjesa duhet të jetë e mbushur me gjethe. Fidanë duhet të jetë i kultivuar në vazo me dhe të mirë humusor dhe të ketë sistem rrënjorë mirë të zhvilluar. Fidanet duhet të jenë të zhvilluara në vazo me madhësi prej 55-65 litra. Furnizuesi për fidanet duhet të dëshmojë me certifikatë fitosanitare dhe të ketë dëshmi për prejardhjen e tyre nga vendet e BE – së.	copë	50	165.00	8,250.00
				Çmimi pa TVSH	22,750.00
				TVSH	0
				Çmimi me TVSH	22,750.00



Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi i pozicionit
1	Furnizimi dhe mbjellja: Rrap (Platanus orientalis) Lartësia e drurit prej tokës deri në përfundim duhet të jetë 3.30-3.50 m (diametri i trunqut Ø100 mm), e gjithë pjesa duhet të jetë e mbushur me gjethe. Fidanë duhet të jetë i kultivuar në vazo me dhe të mirë humusor dhe të ketë sistem rrënjorë mirë të zhvilluar. Fidanet duhet të jenë të zhvilluara në vazo me madhësi prej 55-65 litra. Furnizuesi për fidanet duhet të dëshmojë me certifikatë fitosanitare dhe të ketë dëshmi për prejardhjen e tyre nga vendet e BE – së.	copë	100	82	8,200.00
2	Furnizimi dhe mbjellja: Acer platanoides Crimson King Lartësia e drurit prej tokës deri në përfundim duhet të jetë 3.30-3.50 m (diametri i trunqut Ø100 mm), e gjithë pjesa duhet të jetë e mbushur me gjethe. Fidanë duhet të jetë i kultivuar në vazo me dhe të mirë humusor dhe të ketë sistem rrënjorë mirë të zhvilluar. Fidanet duhet të jenë të zhvilluara në vazo me madhësi prej 55-65 litra. Furnizuesi për fidanet duhet të dëshmojë me certifikatë fitosanitare dhe të ketë dëshmi për prejardhjen e tyre nga vendet e BE – së.	copë	50	82	4,100.00
				Çmimi pa TVSH	12,300.00
				TVSH	-
				Çmimi me TVSH	12,300.00

N.T.P. BASHKËTËRBUÇAJ



Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi i pozicionit
1	Furnizimi dhe mbjellja: Rrap (Platanus orientalis) Lartësia e drurit prej tokës deri në përfundim duhet të jetë 3.30-3.50 m (diametri i trunqut Ø100 mm), e gjithë pjesa duhet të jetë e mbushur me gjethe. Fidanë duhet të jetë i kultivuar në vazo me dhe të mirë humusor dhe të ketë sistem rrënjorë mirë të zhvilluar. Fidanet duhet të jenë të zhvilluara në vazo me madhësi prej 55-65 litra. Furnizuesi për fidanet duhet të dëshmojë me certifikatë fitosanitare dhe të ketë dëshmi për prejardhjen e tyre nga vendet e BE – së.	copë	100	190.00	19,000.00
2	Furnizimi dhe mbjellja: Acer platanoides Crimson King Lartësia e drurit prej tokës deri në përfundim duhet të jetë 3.30-3.50 m (diametri i trunqut Ø100 mm), e gjithë pjesa duhet të jetë e mbushur me gjethe. Fidanë duhet të jetë i kultivuar në vazo me dhe të mirë humusor dhe të ketë sistem rrënjorë mirë të zhvilluar. Fidanet duhet të jenë të zhvilluara në vazo me madhësi prej 55-65 litra. Furnizuesi për fidanet duhet të dëshmojë me certifikatë fitosanitare dhe të ketë dëshmi për prejardhjen e tyre nga vendet e BE – së.	copë	50	128.00	6,400.00
				Çmimi pa TVSH	25,400.00
				TVSH	4,572.00
				Çmimi me TVSH	29,972.00

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi i përcaktuar
1	Furnizimi dhe mbjellja: Rrapi (Platanus orientalis) Lartësia e drurit prej tokës deri në përfundim duhet të jetë 3.30-3.50 m (diametri i tringut Ø100 mm), e gjithë pjesa duhet të jetë e mbështur me gëshe. Fidanet duhet të jenë i kultivuar në vazo me dhe të nisur lumenjor dhe të ketë sistemin rriqorisi mirë të zhvilluar. Fidanet duhet të jenë të zhvilluara në vazo me madhësi prej 55-65 litra. Furnizuesi për fidanet duhet të dëshmojë me certifikate fitosantare dhe të ketë dëshmi për pajardhjen e tyre nga vendet e BE - së.	copë	100	200.00	20,000.00
2	Furnizimi dhe mbjellja: Acer platanoides Crimson King Lartësia e drurit prej tokës deri në përfundim duhet të jetë 3.30-3.50 m (diametri i tringut Ø100 mm), e gjithë pjesa duhet të jetë e mbështur me gëshe. Fidanet duhet të jenë i kultivuar në vazo me dhe të nisur lumenjor dhe të ketë sistemin rriqorisi mirë të zhvilluar. Fidanet duhet të jenë të zhvilluara në vazo me madhësi prej 55-65 litra. Furnizuesi për fidanet duhet të dëshmojë me certifikate fitosantare dhe të ketë dëshmi për pajardhjen e tyre nga vendet e BE - së.	copë	50	330.00	16,500.00
Suarim: Fidanet janë të lirara nga TVSH				Çmimi pa TVSH	36,454.24
36,200.00 € + 254.24 = 36,454.24 € PA TVSH				TVSH	45.76
300.00 € me TVSH mbjellja				Çmimi me TVSH	36,500.00
254.24 € pa TVSH mbjellja					
45.76 € TVSH mbjellja					
36,500.00 € Gjithsej me TVSH					
Në qatim janë të përfshira edhe obligimet ndaj shtetit					
FIDANISHIJA "BYTYQI"		SHERIF BYTYQI			

Pra siç shihet me larte Operatoret kane dhënë çmime te ndryshme dhe dallimi ndërmjet tyre është shume i madh ndërmjet pozicioneve.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konsideron se është përgjegjësi e autoriteti kontraktues që të shpërblejë me kontratë operatorin ekonomik i cili ka ofruar çmime më të lira se çmimet e tregut dhe obligohet autoriteti kontraktues që të kërkoj nga OE i rekomanduar që të rrit sigurinë e ekzekutimit në rast të mos përmbushjes së kontratës, krejt kjo me qëllim të përdorimit dhe shfrytëzimit të fondeve publike në mënyrën më ekonomike.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK-Podujevë";
- 1x1 OE N.T.P "Biti Com"-Podujevë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

